



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL IX/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 9 (nëntë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 28.09.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani
Z. Bashkim Ndrecaj
Z. Brahim Curri
Z. Alban Berisha
Z. Shefket Kolgeci
Z. Xhemajl Kabashaj
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Shqipe Ramaj
Z. Lirim Qatani
Z. Reshat Selimaj
Z. Ardian Kotorri
Z. Bexhet Kuçi
Z. Aziz Bytyqi
Z. Gazmend Gashi
Znj. Bardha Gashi
Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi
Z. Jeton Rrakaqi
Z. Arbërim Basha
Z. Dardan Berisha
Znj. Marigona Gashi
Znj. Florie Bytyçi
Z. Sami Hajdari
Znj. Shkëndije Zenelaj
Z. Osman Selimaj
Z. Leonard Shala
Z. Dugagjin Palushi
Znj. Laureta Tafaj
Z. Gëzim Kryeziu
Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj. Habibe Bytyqi
Z. Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2022;**
- 6. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të miratohet buxheti për vitin 2022. Hap debatin për këtë pikë.

Nexhat Ramadani - përshëndet të pranishmit. Ky projekt-vendim për mua është një prej dokumenteve ma të rëndësishme që duhet të miratohet nga Kuvendi brenda një viti kalendarik. Është e paraparë me ligj që të bëhen diskutime me qytetarë dhe me grupet e interesit në mënyrë që të nxirret dokumenti i cili është në interes të të gjithëve. Mirëpo ka ndodh edhe në të kalumen një grup i caktum të mos votoj buxhtin për shkak të pakënaqësive të veta apo për shkak që s'është pajtu me propozimet e qeverisë. Ne e dimë që përgaditja e një dokumenti të tillë është e vështirë por, për këtë është qeveria. Vërehet një mos interesim i qytetarëve për të marrë pjesë në debate, dhe unë mendoj që përgjegjësia kryesore është e ekzekutivit. Ekzekutivi përpos që e ka obligim të organizojë debate së bashku me Kuvendin e Komunës, ai ka për obligim ti ofrojë Kuvendit një dokument i cili është i pëlqyeshëm dhe i pranueshëm prej shumicës, por kjo fatkeqësisht nuk po ndodh dhe për të qenë ma i sigurtë këto mangësi kanë përcjellë cilin më pak e cilin më shumë edhe qeveritë e kalume.

Projekt-buxheti i ofruar nuk pasqyron interesat reale të qytetarëve por është një projekt-vendim që synon dhe ka interesa të ngushta partiake. Ne si gr. paralamentar kemi marrë pjesë në pjesën dërmuese të debateve dhe kemi dhënë kontributin tone, dhe kemi dhënë vërejtje dhe sugjerime të cilat kanë pas të bëjnë me orientimin e investimeve në projektet më madhore. Propozimi im ka qenë: keni guximin të largohi prej projekteve të cilat janë ne interes individual dhe privat dhe keni guximin që të propozoni projekt-vendime apo projekte të interesit të përgjithshëm, por këto këshilla nuk janë marrë parasysh. Gjatë analizës tone, ne si grup kemi vërejtur këto elemente: 1. Elementi gjithëpërfshirës mendoj që është respektuar në një masë; 2. ka një planifikim jo profesional ngase nuk është dal në teren për të parë gjendjen reale; 3. kalkulimi financiar i projekteve nuk është i saktë, duke pasur parasysh vlerën reale në teren; 4. pjesa kryesore e buxhetit 80-90% shkon për rrugë, ndërkohë që jemi dëshmitar të rregullimit të gjitha rrugëve kryesore dhe tash kemi rrugë që kta i kanë vendos në projekt-propozim, madje që s'kanë emërtim. Brenda këtij projekt-vendimi te një fshat është shkruar dy here e njejta rrugë dhe ka disa raste. Janë rrugë të

cilat janë në buxhet e që janë përfunduar para 2-3 viteve; 5. Mungojnë projektet madhore dhe jetike ,si projekti për zgjidhjen e problemit të ujit,ku disa pjesë nuk kanë furnizim me ujë,pastaj mungojnë buxhetet edhe për kanalizime, i cili është , por për mu është i vogël.Në Leshan rrjeti kryesor i kanalizimit nuk ekziston. Pse mos të kthehemi te këto projekte dhe ti trajtojmë në vija të trasha, por shkojmë ndajmë pare për rrugë që janë kry ose janë private.Ne e kemi votu buxhetin vitet tjera mirëpo kjo qeveri dhe ky Kryetar nuk i ka respektu këto vendime,dhe na ka fy neve.Sot në këtë seancë ftoj prokurorinë që të merret me këtë qështje,sepse këtu miliona euro menaxhon një njeri. Edhe ne jemi fajtor që kemi toleru në këtë masë.Kemi ngrit zanin por ndoshta jo mjaftueshëm, edhe pse nuk i pëlqej metodat që përmenda më herët. Nuk ka punë të sinqerta dhe e dimë që kualiteti i punimeve është katastrofal,dhe e dimë që i ndërron projektet dhe vendos ku mi qu,dhe kjo është e papranueshme. Te planifikimet: në Mohlan ,e propozuar ,ndërtimi i rrugës “Jetish Kabashi”-segment,”Dërmish Kabashi”.S’ka rrugë Dërmish Kabashi,është oborr. Përgjegjësi e Kryetarit është që të menagjojë në mynyrën ma të ndershme,dhe kjo që bën është e pandershme.Unë mendoj që s’keni të drejtë me na thane votone këtë buxhet,edhe pse është një projekt-vendim i cili i duhet qytetarëve,dhe nese s’votohet ka me pas pasoja,por ti mbaj ai këto pasoja dhe jo ne. Projektet që janë që disa vite përsëriten.Baqevc, rruga “Haxhi Qerimi”,pastaj Bukosh, rruga “Maliq Rama”brenda vitit 2022 është dy here.Vitin e kalum në Vraniq kanë qenë pikërisht rrugët që janë tash. Kërkoj prej Asambleistëve që një projekt-vedim të tillë nuk është mirë me votu,sepse nuk është në të mirë të qytetarëve.

Xhemajl Kabashi - përshëndet të pranishmit.Vërejtjet e përgjithshme i tha Nexhati. Te planifikimi i Drejtorisë së Bujqësisë : po vazhdon avazi i vjetër i katër vite më pare,ku kjo qeveri ndërtimin e rrugëve apo infrastrukturën në bujqësi dhe pylltari ,gjysmën e investimeve kapitale prap e ka nda n’këtë segment,dhe nuk e di pse në bujqësi, rrugët duhet me shku në drejtori të infrastructures.Pastaj e ka planifiku ni buxhet për “ shtigjet e ecjes”,dhe këto mujm mi qu te infrastruktura,te rinia,kultura dhe sporti.Ç ka po ndodh,qe 4 vite fermeri ka mbet pa grante,pa suvencione? Te planifikimi: projekti në Krushicë të poshtme ishte ”Meremetimi i lapidarit të dëshmorit Muhamet Kabashi”,është kry këtë vit dhe po figuron prap.

Laureta Tafa - përshëndet të pranishmit.Kryetar,edhe këtë buxhet si çdo vit tjetër i është imponuar qytetarëve.Në këtë qeverisje çdo shpenzim është bo pa projekt në të mirë të qytetarëve.Në Grejkoc ke vendos me shtru rrugën e cila është e shtrune .Nuk e ke marrë parasysh kërkesën për zgjerimin e urave,nuk e ke marrë parasysh rregullimn e trotuareve .Kryetar, më vje mirë që po shkon e paq shumë shëndet.

Bashkim Ndrecaj - përshëndet të pranishmit.Ky projekt-buxhet është praktikë e katër viteve.Devijimi i projekteve të votuara në Asamblenë Komunale nuk na lejon me votu këtë projekt-buxhet.Nuk e ki parapa kanalin e ujrave atmosferike në Shirokë,një premtim qe një vit.Si të votoj kur nuk e ki parapa as një meter gyp në Budakovë,dhe kurr s’ke mendu për atë fshat as një meter ujsjellës me bo.32 shtëpi në Shirokë i kemi, të cilat rrezikohen prej çdo reshje të shiut.U shtri ujsjellësi në Maqitevë nga qeveria zvicerrane,banorët kanë bo kërkesë për rregullimin e burimit dhe ski parapa asgjë.Me date 2 shtator kam bo kërkesë në drejtorinë e pronës për me bo piketimin e rrugës “Faik Konica” në Shirokë dhe përgjigja ishte që piketimi bëhet kur të plotësohen kushtet.Unë ju kërkoj falje qytetarëve të Komunës së Suharekës që nuk muj me votu këtë buxhet për ato arsye që i thash.

Ardian Kotorri - përshëndet të pranishmit.Jami i shqetësuar për gjuhën,komunikimin që po flitetet kohët e fundit në skenën politike.Unë buxhetin e arsyetoj, që në mënyrë personale secili mos me votu ,por jo këtë gjuhë.Para katër viteve ne nuk e kemi votu buxhetin dhe kemi pas arsytet tona,por ky pushtet sot nuk po bon filma me kamera siq ka bo pushteti atë kohë.Ky kryetar me gjithë ato ofendime që i bëte ,megjithëatë nuk po ju poshtron.Këtë gjuhë nuk e pranojnë qytetrët e Therandës dhe ju do ta shihni me datën 17.Ndërsa për buxhetin nuk mendoj që janë të bazume,kemi pas edhe debate publike dhe le të mbetet në ndërgjegjen e secilit.

Nexhat Ramadani - koleg asambleist,unë nuk di që përdora fjalë fyese.Nëse unë i them dikujt i pandershëm mbetet në ndërgjegjen time por fyrje nuk është.

Xhemajl Kabashi - përmendet qështja e kamerave dhe dua një sqarim prej juristave. Unë e di që seancat janë publike ,dhe ka drejtë edhe publiku edhe kamera me marrë pjesë, nëse është e ndalune tregoni me cilin ligj dënohet.

Ardian Kotorri - po flasim për vitin 2017,kryetari i forumit të LDK-së është kamerman dhe ka ardh këtu,ka pas tendencë poshtrimi.

Dugagjin Palushi - sa i përket buxhetit unë pajtohem me parafolësit dhe shumicën që pata mi cek, i cekën.Planifikimi i buxhetit bëhet në baza klienteliste,dhe qytetarët e Komunës sonë gjatë gjithë kësaj qeverie nuk janë trajtu barabartë dhe kjo bie ndesh me ligjin.Dikuj ju kanë shtru edhe oborret dhe dikush ka 750 metra siq është rruga Mursel Buqa në Budakovë.Vendosen 65 mijë euro për vitin 2022 për fshatin Budakovë,7 rrugë në listë dhe shkruhen Mursel Buqa asfalt,kjo është fyerje.Mua më brengos puna e ujësjellësit.Shumë fshatra nuk kanë ujë.Për ujësjellës në Komunë prap bohet shaka, 93,577.00 euro, dhe ky fakt të bën me mendu sa jo serioz trajtohet një qështje që është ma seriozja.Dhe te kanalizimi njejtë.Unë për vete nuk e shoh të arsyeshme me votu këtë buxhet.

Jeton Rrakaqi - përshëndet të pranishmit, kolegët Asambleist dhe veqanërisht gr.parlamentar të PDK-së për korrektësinë.Grupi parlamentar i PDK-së gjithmonë të ka përkrah në interes e qytetarëve sa here ke pas nevojë,e ju keni thirrë veq kur keni pas zor.Nuk keni pas plan emergjent dhe as ekspert të kësaj fushe.Qe 21 vite Suhareka nuk ka plan urbanistik dhe ka objekte banosore që janë ndërtu qe 20 vite dhe nuk kanë pranim teknik.Vërejtet tona kryesisht janë te cilësia e punimeve.Në fshatin Gelancë kanë qenë dy ura dhe parku,por nuk janë bo.Rruga “Sherif Qadraku”qe tri vjet vje, rruga “Qershia”ka tri segmente dhe duhet me cek cili.Në Gjinoc rruga “Pavarësia”qe dy tre here vje,rrethoja e shkollës në Gjinoc ,nuk është bo,I kem nda 500 mijë euro për sheshin dhe nëpër debate ke thënë që je konsultu me Asambleistët e qytetit por s’është e vërtetë.42 punëtor shëndetësor,rrogat jubilarë i kanë marrë me përmbaues.Grupi parlamentar i PDK-së nuk e voton buxhetin.

Kryetari - përshëndet të pranishmit.Falemnderon Asambleistët për punën dhe bashkëpunimin.Të gjitha dëgjimet publike për buxhetin janë mbajt në afat dhe të gjithë keni qenë të ftuar nëpër fshatra.Buxheti s’është i imi,është i qytetarëve.Faleminderit për këshillat e kritikata.I uron suksese Asambleistëve.

Leonard Shala - përshëndet të pranishmit. Rreth lagjes ku jetoj unë,që për kto katër vite fal bashkëpunimit që kemi pas me Kryetarin dhe me ty Kryesues por edhe falemnderues ndaj Asambleistëve që kanë votu projekte, në tërësi është përmbyll infrastruktura në lagjen “Fidanishte”.Mirëpo i vetmi propozim në këtë bugjet për trotuaret rreth varrezave të dëshmorëve është inkorporu n’buxhet“.Falemnderon asambleistët për bashkëpunimin dhe i uron suksese.

Jeton Rrakaqi - falemnderon Leonard Shalën për bashkëpunimin.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**9 për, 18 kundër
nuk Miratohet Pika 2.**

Pika 3. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - a keni pyetje?

Kryesuesi - nuk ka pyetje.

Takimi përfundoi: 11:10

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj